

TRAJNIMI I ASPIRANTËVE PËR DREJTOR DHE I DREJTUSVE NË PUNË, LIDHUR ME ZBATIMIN E LIGJSHMËRISË.

NJOHURITË DHE TREGUESIT SIPAS STANDARDEVE ZYRTARE.

Standardi I

Zhvillimi i vizionit dhe i strategjisë për përmirësimin, planifikimin dhe për vlerësimin e arritjeve të institucionit arsimor.

▪ **Njohuritë:**

-ligjet dhe aktet nënligjore të arsimit parauniversitar, politikat, proceset dhe skemat kombëtare të reformës shkollore;

▪ **Tregues në praktikë:**

-zbaton procedura drejtimi,të qarta dhe të sigurta, në përshtatje me politikat zyrtare në nivel kombëtar dhe lokal;

-siguron transparencë, besueshmëri dhe integritet gjatë përdorimit të të dhënave;

-siguron arritje nëpërmjet eliminimit të proceseve jofunksionale dhe përdorimit të efektshëm të procedurave standarde nga burimet njerëzore të institucionit;

-siguron një funksionim cilësor të institucionit, duke përfshirë gjithë burimet njerëzore në këtë proces.

Standardi 2.

Drejtimi në ekip për zbatimin e kurrikulës, mësimdhënies dhe të nxënit të suksesshëm

Njohuritë:

-kurríkula e arsimit parauniversitar në Shqipëri, ndryshimet pedagogjike, vlerësimin e nxënësve dhe reflektimin për të nxënit;

-përdorimin e të dhënave për përmirësimin e performancës së shkollës, planifikimin dhe vlerësimin e saj;

-menaxhimin e kurrikulën që zhvillohet në institucionin arsimor.

▪ **Tregues në praktikë:**

-merr pjesë në procesin e zhvillimit profesional të mësuesve në nivel shkolle, për të përmirësuar procesin e të nxënit dhe të arritjeve të nxënësve;

Standardi 3.Menaxhimi efektiv i njerëzve, burimeve dhe i financave

• **Njohuritë:**

-procese efektive të menaxhimit të burimeve njerëzore, përfshirë proceset e emërimit dhe të vlerësimit, në përputhje me legjislacionin e punësimit në Shqipëri;

- planifikimin strategjik dhe periodik të burimeve financiare dhe njerëzore;
- raportimi periodik në përputhje me praktikën legjislative të sistemit arsimor parauniversitar në Shqipëri;
- rregullimin ligjor, duke përfshirë shëndetin dhe sigurinë;
- qeverisja dhe llogaridhënia lokale.

- **Tregues në praktikë:**

- gjen rrugë dhe mbështetje profesionale për të minimizuar dobësitë;
- planifikon, monitoron dhe vlerëson sistematikisht duke përdorur dëshmi dhe evidenca të proceseve të mësimdhënies, të të nxënit dhe të arritjeve, për të nxitur përmirësimin;
- përdor burimet sipas planifikimit, duke siguruar edhe ruajtjen e vlerave mjedisore.

Standardi 4. Drejtimi i ndryshimeve transformuese në institucionin arsimor në përputhje me kontekstin ligjor të arsimit shqiptar

- **Njohuritë:**

- menaxhimi i burimeve njerëzore dhe i inteligjencës emocionale;
- dokumentet ligjore për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe organizmat brenda institucionit, për të mbështetur këshillimin dhe udhëzimet e fëmijëve;
- analizën e të dhënave të ndryshme që siguron institucioni;

- **Tregues në praktikë:**

- është fleksibël në menaxhimin e problematikave që sjellin ndryshimet në sistemin arsimor;
- mbështet zhvillimin e sistemit arsimor në tërësi, duke bashkëpunuar me të tjerët dhe duke ndarë njohuritë dhe praktikat pozitive;
- zbaton legjislacionin dhe vlerat shqiptare për respektimin dhe mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve.

Standardi 5. Drejtimi i institucionit në partneritetet me prindërit dhe komunitetin e gjerë

- **Njohuritë:**

- rolet e rëndësishme të komunitetit dhe të burimeve të disponueshme për institucionin, si: kujdesi shoqëror, shëndetësor, biznesi lokal, financiar dhe infrastrukturor;
- çështje të ndryshme të fëmijëve dhe të familjeve të tyre, të cilat ndikojnë të nxënët, duke përfshirë punësimin, strehimin, nivelin e të ardhurave dhe profilin ekonomik të komunitetit që institucioni i shërben;
- marrëdhëniet e ndërsjella mes institucionit e komunitetit dhe bashkëpunimin e tyre për të përmirësuar vazhdimisht edukimin e të gjithë fëmijëve.

- **Tregues në praktikë:**

- krijon dhe ruan një partneritet të frytshëm nëpërmjet komunikimeve formale dhe joformale;
- bashkëpunon në projekte dhe veprimtari të përbashkëta me grupet e interesit, për përmirësimin e institucionit, duke i promovuar ato;
- përfshin partnerë të jashtëm nga komuniteti dhe biznesi për zhvillimin e institucionit, në drejtim të planifikimeve strategjike dhe të përditshme;

-bashkëpunon me organizma shtetërorë të shëndetit, të kujdesit shoqëror, me policinë dhe qeverisjen lokale për të mbështetur zhvillimet e institucionit.

Standardi 6. Lider pedagogjik, model i zhvillimit të vetes dhe të të tjerëve

- **Njohuritë:**

-kodi i sjelljes, vlerave dhe etikës profesionale të mësuesve dhe drejtuesve të institucioneve arsimore.

- **Tregues në praktikë:**

-trajton njerëzit në mënyrë të drejtë, transparente, me dinjitet dhe me respekt;

-tregon zero tolerancë ndaj korrupsionit ose favorizimit të padrejtë, mbështetur nga zhvillimi dhe zbatimi i politikave zyrtare për burimet njerëzore, në përputhje me bazën ligjore përkatëse.